



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 154

Tiranë – E enjte, 28 gusht 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 295, datë 25.8.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 20763
Dekret i Presidentit nr. 296, datë 25.8.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 20763
Dekret i Presidentit nr. 297, datë 25.8.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 20763
Dekret i Presidentit nr. 298, datë 25.8.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 20763
Dekret i Presidentit nr. 299, datë 25.8.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 20764
Dekret i Presidentit nr. 300, datë 25.8.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 20764
Dekret i Presidentit nr. 301, datë 25.8.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 20764
Dekret i Presidentit nr. 302, datë 25.8.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 20765
Dekret i Presidentit nr. 303, datë 25.8.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 20765
Dekret i Presidentit nr. 304, datë 25.8.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 20765

Dekret i Presidentit nr. 305, datë 25.8.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	20766
Dekret i Presidentit nr. 306, datë 25.8.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	20766
Dekret i Presidentit nr. 307, datë 25.8.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	20766
Dekret i Presidentit nr. 308, datë 25.8.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	20767
Dekret i Presidentit nr. 309, datë 25.8.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	20767
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 21, datë 22.8.2025	Për një shtesë në udhëzimin nr. 26, datë 25.11.2019, “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.....	20767
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 492, datë 22.8.2025	Për një ndryshim në urdhrin nr. 483, datë 31.7.2025, “Për delegim kompetence”, i ndryshuar.....	20768
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 189, datë 12.8.2025	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin korrik 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.....	20768
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 190, datë 12.8.2025	Mbi licencimin e shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	20770
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 191, datë 12.8.2025	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet prodhues 35.6 mw.....	20771
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 192, datë 12.8.2025	Mbi dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. si mjet për garantimin e përbushjes së detyrimit ndaj “Banka e Tiranës” sh.a., “Banka OTP Albania” sh.a., “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a dhe “Union Bank” sh.a.....	20773
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 193, datë 12.8.2025	Mbi procedurën e trajtimit të kërkesave të të licencuarve, të cilët plotësojnë kriteret ligjore për marrjen e autorizimit nga ERE, për transferim asetesh në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, që në fazën e parë të aplikimit.....	20775
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 194, datë 12.8.2025	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin nëpërmjet vendosjes së barrës sigurorese të aseteve fikse të shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k.	20777

**DEKRET****Nr. 295, datë 25.8.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Altin Hysen Voci
2. Altin Sherif Xhepa

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 296, datë 25.8.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Perjan Edmond Duro
2. Bujar Ismail Bakiu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 297, datë 25.8.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Albana Agron Sturm
2. Ervin Xhavit Hasanaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 298, datë 25.8.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Thoma Stefan Lina
2. Klarita Mustafa Karaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 299, datë 25.8.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Petrit Teti Selenica

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 300, datë 25.8.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Kastriot Alush Thaçi
2. Tomas Astrit Fero
3. Gentiana Bujar Xhepa

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 301, datë 25.8.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Sokol Ndue Lucaj
2. Krisman Shkelqim Maloku
3. Nesti Jorgji Gollosi



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 302, datë 25.8.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënie e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Alketa Simion Vaso
2. Klaudeta Emri Lala
3. Enji Thoma Lina
4. Alketa Demirali Auer

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 303, datë 25.8.2025

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Tedi Llazar Semini
2. Xhoiel Bardh Rica
3. Martina Bafti Alia

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 304, datë 25.8.2025

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Kristi Fatos Qato
2. Enrik Viktor Ndou
3. Mirdit Ylli Risto

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 305, datë 25.8.2025****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Desara Alban Parllaku
2. Saimir Zydi Baçova
3. Gerta Xhan Hajrullahi
4. Lorenc Sokrat Simaku
5. Flemento Flamur Mena

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 306, datë 25.8.2025****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Albion Ramadan Ndreka
2. Oria Albion Ndreka

3. Fatushe Genci Goethals
4. Evelina Teki Veliu
5. Hermes Bujar Xhika
6. Dorena Refik Batha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 307, datë 25.8.2025****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Armand Arben Refati
2. Mael Armand Refati
3. Xhedi Gjiri Lekgegaj
4. Orhan Nöman Gülen

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

**DEKRET****Nr. 308, datë 25.8.2025****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Aldo Ahmet Leka
2. Nalan Nöman Gülen
3. Mario Gëzim Hasani
4. Klevis Andon Sota
5. Ilva Rrapo Saka

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 309, datë 25.8.2025****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Esad Erban Hoxha

2. Fatma Erban Hoxha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

UDHËZIM**Nr. 21, datë 22.8.2025****PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.
26, DATË 25.11.2019, “PËR MËSUESIN
NDIHMËS PËR NXËNËSIT ME AFTËSI
TË KUFIZUARA NË INSTITUCIONET
PUBLIKE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 3, të nenit 65, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe të urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 26, datë 25.11.2019 “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, pas pikës 4, të shtohet pika 4.1 me këtë përmbajtje:

“4.1 Në raste të veçanta, bazuar në vlerësimin e ngarkesës mësimore të mësuesve ndihmës, me miratim të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, brenda numrit aktual të mësuesve ndihmës, një mësues ndihmës mund të punojë edhe me deri në dy nxënës me aftësi të kufizuara, bazuar në nivelin e vështirësisë dhe nevojës për mbështetje që paraqet nxënësi.”

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për



arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Orjana Osmani

URDHËR

Nr. 492, datë 22.8.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 483, DATË 31.7.2025, “PËR DELEGIM KOMPETENCE”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Në pikën 1 të urdhrit nr. 483, datë 31.7.2025, “Për delegim kompetence”, i ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

“Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 19.8.2025–21.8.2025, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Klajd Karameta”.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, z. Klajd Karameta, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

VENDIM

Nr. 189, datë 12.8.2025

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN KORRIK 2025, PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.8.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2280/1 prot., datë 7.8.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin korrik 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

I. Aspektet ligjore dhe procedurale

1. Paraqitja e kërkesës nga “FSHU” sh.a.

Shoqëria “FSHU” sh.a., me shkresën nr. 4289 prot., datë 5.8.2025, protokolluar në ERE me nr. 2280 prot., datë 5.8.2025, ka depozituar kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin korrik 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

2. Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nga ERE

Kërkesa është shqyrtuar në përputhje me nenin 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe “Metodologjisë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së



Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar.

II. Analiza e përlogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin korrik 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV

1. Blerja e energjisë në bursë

Për muajin korrik 2025, “FSHU” sh.a. ka siguruar sasinë e nevojshme të energjisë elektrike për këtë kategori klientësh përmes blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX), duke u bazuar në profilet ditore të prokuruar, çmimet ditore/orare dhe vlerat përkatëse të faturuara.

2. Përlogaritja e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes (ÇBEt)

Bazuar në të dhënat e paraqitura, “FSHU” sh.a. ka përlogaritur çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për muajin korrik 2025 në vlerën 12.23 lekë/kwh. Kjo vlerë është verifikuar edhe nga ERE, nëpërmjet një rillogaritjeje, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 12.23 lekë/kwh, në përputhje me përlogaritjet e paraqitura nga shoqëria.

3. Komponentët sipas metodologjisë (neni 8, vendimi nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar)

Në përputhje me metodologjinë përkatëse, komponentët e përdorur për përlogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë si më poshtë:

- Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt) për muajin korrik 2025: 12.23 lekë/kwh;

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 shkurt 2025 – 31 dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 16.12.2024: 0.85 lekë/kwh;

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 288, datë 23.12.2024, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022”: 1.55 lekë/kwh;

- Kostot administrative: 1.06 lekë/kwh;

- Kurset zyrtare të këmbimit të publikuara nga Banka e Shqipërisë (lekë/euro), për çdo datë respektive në harkun kohor 28.6.2025–30.7.2025.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të “FSHU” sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2025, përlogaritet si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin korrik 2025

	Njësia	Çmimi
CBEt Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	12.23
Pr Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.37
CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr * CBEt + TRr + TSHt + CA	Lekë/kWh	16.06

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezultoi se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë 16.06 lekë/kwh, për muajin korrik 2025.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së

Fundit, për muajin korrik 2025, prej 16.06 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategoritë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data



e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTAR I BORDIT TË ERE-s
Petra Lika

VENDIM
Nr. 190, datë 12.8.2025

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ENERGOVIA.ALBANIA” SHPK NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “d”, dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, 13 dhe 14, pika 9 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.8.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1693/15 prot., datë 7.8.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Energovia.Albania’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 113, datë 3.6.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Njoftimi për fillimin e procedurës u botua në median e shkruar më datat 4.6.2025 dhe 5.6.2025, si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Brenda afatit të përcaktuar për paraqitjen e komenteve apo

objeksioneve (deri më 13.6.2025), nuk u paraqit asnjë koment.

- ERE, me shkresën nr. 1693/7 prot., datë 5.6.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim. Kjo shkresë u kthye mbrapsht nga shërbimi postar, ndaj më 11.6.2025 iu dërgua shoqërisë nëpërmjet e-mail-it një kopje e skanuar.

- Në përgjigje, me e-mail-in e datës 20.6.2025, shoqëria depozitoi pjesërisht dokumentacionin e munguar, duke njoftuar se vërtetimin e gjendjes gjyqësore për administratorin do ta sillte sapo të pajisej me të dhe të përkthehej. Po atë ditë, ky dokumentacion u depozitua edhe fizikisht në protokollin e ERE-s me nr. 1693/9 prot., datë 20.6.2025.

- Për sa më sipër, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 136, datë 7.7.2025, është vendosur zgjatja e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s deri në 30 (tridhjetë) ditë për aplikimin e shoqërisë për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, duke i lënë detyrë shoqërisë që brenda 20 (njëzet) ditëve të depozitojë në ERE vërtetimin për gjendjen gjyqësore të administratorit të saj.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendimmarrje, me shkresën nr. 1693/11 prot., datë 9.7.2025, shkresë, e cila është kthyer sërish mbrapsht nga shërbimi postar, ndaj i është dërguar shoqërisë një kopje e skanuar me e-mail-in e datës 15.7.2025.

- Me e-mail-in e datës 16.7.2025, protokolluar në ERE me nr. 1693/12 prot., datë 16.7.2025, shoqëria ka përditësuar adresën e saj dhe ka njoftuar për të depozituar brenda afatit dokumentin e munguar.

- Me e-mail-in e datës 28.7.2025, protokolluar në ERE me nr. 1693/13 prot., datë 28.7.2025, dhe së fundi, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1691/14 prot., datë 4.8.2025, shoqëria ka depozituar në ERE-dëshminë e penalitetit të administratorit në format origjinal.

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.



- Në referencë të përcaktimeve të rregullores, aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”; pikën 1.2, gerrat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pikën 1.3, gerrat “a”, “b” dhe “c”; si dhe pikën 2.5.

- Vlefshmëria kontratave të shërbimit për stafin teknik (shërbime ligjore dhe të kontabilitetit) nuk mbulon të gjithë afatin 5-vjeçar të licencës, ndaj brenda afatit të përfundimit të tyre, pra brenda datës 1.2.2026 shoqëria duhet që të depozitojë kontratat e rinovuara për shërbimet e jashtme, ose çdo dokument tjetër në lidhje me disponimin e stafit teknik.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të zbatuar në vijim edhe kushtet e përcaktuara në këtë vendim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Energovia.Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Brenda datës 1.2.2026, shoqëria duhet të depozitojë kontratat e rinovuara për shërbimet e jashtme, ose çdo dokument tjetër në lidhje me disponimin e stafit teknik.

3. Ky vendim është objekt rishikimi në lidhje me plotësimin/mosplotësimin e pikës 2.

4. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Energovia.Albania” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTAR I BORDIT TË ERE-s
Petra Lika

VENDIM Nr. 191, datë 12.8.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “INFOTELECOM- ALBSOLAR 4” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET PRODHUES 35.6 MW

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.8.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2207/1 prot., datë 7.8.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Infotelecom-Albsolar 4’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2207 prot., datë 30.7.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me vendndodhje në rrugën “Gjorica e Poshtme”, Njësia Administrative Gjoricë, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër. Në formularin – shtojca 2 – të kërkuar sipas Rregullores së licencimit, shoqëria ka deklaruar se kapaciteti i instaluar është 40 mw, por konstatohet se nga dokumentacioni bashkëlidhur aplikimit për licencim (Marrëveshja me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me nr. 9476 prot., datë 4.12.2024) kapaciteti i instaluar është 35.6 mwac, ndaj dhe ERE do t'i referohet këtij kapaciteti.

- Megjithatë në marrëveshjen e lidhur me MIE-n kapaciteti i centralit fotovoltai është përcaktuar si 35.6 mwac, ERE, në zbatim të praktikës së saj



rregullatore dhe kuadrit ligjor, i referohet kapacitetit të instaluar në mw. Kjo sepse kapaciteti nominal i njësisë gjeneruese përcaktohet sipas standardeve teknike vetëm në mw, ndërsa termi mwac lidhet me fuqinë efektive pas konvertimit nga DC (rryma e drejtë) në AC (rryma alternative). Përdorimi i mw siguron uniformitet, krahasueshmëri dhe saktësi në dokumentacionin zyrtar për të gjitha teknologjitë gjeneruese (fotovoltaike, hidro, eolike etj.).

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë, sipas germave (“a”, “b” dhe “c”), si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas aneksit A.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2, të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germës “a”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germës “a”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germës “b”.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

- Shoqëria ka depozituar “Marrëveshjen për zhvillimin e projektit në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e impiantit fotovoltai, me kapacitet të instaluar 35,6 mwac dhe kapacitet të mbështetur 35,6 mwac, që do të vendoset në Bashkinë Bulqizë, rruga ‘Gjoricë e Poshtme’, Shqipëri”, me nr. 9476 prot., datë 4.12.2024, nënshkruar ndërmjet MIE-s dhe Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive “Solar Park Gjoricë” sh.p.k., “Info-Telecom” sh.p.k dhe “Adame Mühendisklik Enerji SAN. TİC. LTD. ŞTİ”.

- Shoqëria ka marrë miratimin në parim të pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit nëpërmjet shkresës së “Operatorit të Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a., me nr. 2960/1 prot., datë 31.5.2024, për

lidhjen e Parkut Fotovoltai “Gjorica Solar”, me rrjetin 110 kV të transmetimit.

- Shoqëria ka bërë me dije se është pajisur me lejen e zhvillimit, të miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) nr. 41, datë 29.5.2024, me subjekt zhvillues “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k. Duke qene se konstatohet mospërputhje në datën e referuar të kësaj lejeje zhvillimi dhe datës së regjistrimit në QKB (27.8.2024), që rezulton më e vonë se vetë data e pajisjes me leje zhvillimi, shoqëria duhet të japë sqarimet përkatëse përfshirë nëse bëhet fjalë për një lapsus në referimin e vitit të dhënies së kësaj lejeje.

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”

Shoqëria duhet të depozitojë:

- Dëshminë e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burjeve, për administratorin dhe vetë shoqërinë (germa “b”).

- Informacion/dokumentacion mbi bërjen efektive të stafit të përcaktuar në strukturën organizative të depozituar, si p.sh. marrëveshje shërbimi të jashtme etj., duke sqaruar nëse kjo strukturë është aktualisht funksionale apo do të bëhet efektive në të ardhmen (germa “c”).

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

Shoqëria duhet të depozitojë:

- Vërtetimin që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve tatimore (germa “a”).

- Dokumentacion vërtetues të disponimit të mbështetjes financiare për të mbuluar vlerën e investimit sipas kontratës me MIE-n (germa “b”).

- Planin e biznesit në format të printuar, original ose fotokopje të njësuar me origjinalin, të dedikuar për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe në përputhje me lejet/autorizimet e tjera (germa “c”).

Pika 2, “Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës”

2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin/informacionin si më poshtë:

- Të informojë mbi kapacitetin e instaluar të secilës njësi gjeneruese të centralit, si dhe të paraqesë një dokument teknik (p.sh. garancinë përkatëse, nëse



e disponon) në kuptim të parashikimit të bërë në lidhje me jetëgjatësinë e projektit (30 vjet), me qëllim vlerësimin e jetëgjatësisë së pritshme të centralit në raport me afatin e disponimit të licencës (germa “a”).

- Marrëveshjen për Zhvillimin e Projektit të nënshkruar me MIE-n në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin (germa “b”).

- Miratimin përfundimtar/marrëveshjen për pikën e lidhjes të nënshkruar me OST sh.a. (germa “c”).

- VNM-në paraprake (germa “e”).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 35.6 mw, me vendndodhje në rrugën “Gjorica e Poshtme”, Njësia Administrative Gjoricë, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTAR I BORDIT TË ERE-s
Petra Lika

VENDIM

Nr. 192, datë 12.8.2025

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT TË ERE-s PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “SPV BLUE 2” SHPK SI MJET PËR GARANTIMIN E PËRMBUSHJES SË DETYRIMIT NDAJ “BANKA E TIRANËS” SHA, “BANKA OTP ALBANIA” SHA, “INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” SHA DHE “UNION BANK” SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 9, pika 8, dhe 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.8.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2200/1 prot., datë 6.8.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SPV Blue 2’ sh.p.k. për dhënie e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj të tretëve”,

Konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënie e autorizimit për shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2200 prot., datë 29.7.2025 ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për barrësimin e kuotave të saj (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese) me qëllim garantimin e shlyerjes së detyrimeve të lindura nga kontrata e kredisë sindikale në favor të “Banka e Tiranës” sh.a., “Banka OTP Albania” sh.a., “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a. dhe “Union Bank” sh.a., ku Agjent i



Kredisë dhe i kolateralit është zgjedhur “Banka e Tiranës” sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 296 në datë 30.12.2024 në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaiik “Blue 2” me kapacitet prodhimi 50 mw, me vendndodhje në Sheq Marinas.

3. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar i plotë dokumentacioni në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5, 6, 7 dhe 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2022, si vijon:

- **Neni 5, pika 2** – kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë, në përputhje me kërkesat e rregullores.

Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- **Neni 5, pika 4** – dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike.

- **Neni 5, pika 5** – shoqëria ka deklaruar se kërkon që të mos jenë të hapura për publikim dokumentet si më poshtë: Marrëveshja e Barrës Siguruese mbi kuotat, nr. 4343 rep., nr. 1884 kol., datë 30.5.2025; Marrëveshja e Kredisë Sindikale, nr. 4338 rep., nr. 1877 kol., datë 30.5.2025; si dhe pasqyrat financiare të shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. Kjo kërkesë është vlerësuar e pranueshme, për shkak se përmbajtja e këtyre dokumenteve ka natyrë sensitive, duke përfshirë të dhëna financiare dhe personale të palëve të përfshira.

4. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 8:

- **Pika 1** – janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet për vendosjen e barrës siguruese, përshkrimi i detyrimeve dhe deklarata mbi statusin e kuotave.

- **Pika 2** – janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror si më poshtë vijon:

- **germa “a”** - ekstrakti historik i regjistrit tregtar.

- **germa “b”** - vendimi i organeve drejtuese: Është depozituar vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k., si dhe vendimet e Asamblesë të secilit ortak, ku miratohet vendosja e barrës siguruese mbi kuotat si mjet për garantimin e shlyerjes së kredisë sindikale.

- **germa “c”** – marrëveshjen përkatëse:

Kontratë kredie, nr. 4338 rep., nr. 1877 kol., datë 30.05.2025, nënshkruar nga palët, ku rezulton që qëllimi i përdorimit të kredisë është për rifinancimin e pjesës së pashlyer të huas ekzistuese, ndërtimin e impiantit fotovoltaiik, duke përfshirë, por pa u kufizuar te kostot, shpenzimet dhe interesat e tij, financimin e llogarive të lidhura me ndërtimin e impiantit fotovoltaiik, pagesën e çdo takse apo tarife të lidhur me të.

- **Pika 3** – shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

5. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve, nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohej nga kuadri ligjor ose nga marrëveshjet kontraktuale në fuqi.

- *Vendosja e këtij kushti bëhet për të garantuar se autorizimi i dhënë nga ERE mbetet i kufizuar vetëm në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj rregullatore, pa ndërhyrë apo anashkaluar detyrimet ligjore ose kontraktuale që mund të ketë shoqëria ndaj autoriteteve të tjera ose palëve të përfshira në marrëdhënie financiare apo tregtare. Në këtë rast, duke qenë se marrëveshja është nënshkruar me banka vendase, është përgjegjësi e shoqërisë të respektojë çdo detyrim tjetër jashtë kompetencës së ERE-s që mund të rrjedhë nga këto marrëveshje.* Në referencë të nenit 9, pika 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 235, datë 26.11.2022, shoqëria është e detyruar të dorëzojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga momenti i



reflektimit në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj.

- Shoqëria detyrohet të njoftojë ERE-n në rast të heqjes së barrës siguroese ose të ekzekutimit të saj të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Banka e Tiranës” sh.a., “Banka OTP Albania” sh.a., “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a. dhe “Union Bank” sh.a., ku agjent i kredisë dhe i kolateralit është zgjedhur “Banka e Tiranës” sh.a. (sipas kontratës së kredisë sindikale nr. 4338 rep., nr. 1877 kol., datë 30.5.2025).

2. Dhënia e autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj.

4. Shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguroese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

6. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTAR I BORDIT TË ERE-s
Petra Lika

VENDIM

Nr. 193, datë 12.8.2025

MBI PROCEDURËN E TRAJTIMIT TË KËRKESAVE TË TË LICENCUARVE, TË CILËT PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE, PËR TRANSFERIM ASETESH NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR, QË NË FAZËN E PARË TË APLIKIMIT

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; neneve 3, 6, 7 dhe 8 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; nenit 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikave 1.3 dhe 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.8.2025, mbasi shqyrtoi propozimin sipas praktikës memo me nr. 2307/3 prot., datë 12.8.2025, të Këshilltares së Bordit dhe Sekretarit të Përgjithshëm, në kuadër të shqyrtimit të kërkesës së shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k., “Për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet marrëveshjes siguroese) të aseteve fikse të saj, në favor të ‘Banka e Tiranës’ sh.a., ‘Banka OTP Albania’ sh.a., ‘Intesa Sanpaolo Bank Albania’ sh.a.”, si dhe u njoh me qëndrimin e Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 119, datë 21.7.2016, ka miratuar “Rregulloren e procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”.

- Rregullorja e procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit, në nenin 8 të saj, përcakton se: “Pasi shqyrton kërkesën e paraqitur nga subjekti i licencuar, në lidhje me transferimin e aseteve, Bordi i ERE-s shprehhet me vendim për fillimin ose jo të procedurave, sipas rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s dhe kësaj rregulloreje.”



- Në referencë të nenit 10, pika 1, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, citohet se: “Shqyrtimi i kërkesës për transferimin e aseteve, nëse i licencuari ka plotësuar tërësisht informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, do të bëhet brenda 45 ditëve pune nga marrja e vendimit për fillimin e procedurave të shqyrtimit.”.

- Në relacionin me nr. 2199/1 prot., datë 7.8.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SPV Blue 2’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet marrëveshjes siguruese) të aseteve fikse të saj, në favor të ‘Banka e Tiranës’ sh.a., ‘Banka OTP Albania’ sh.a., ‘Intesa Sanpaolo Bank Albania’ sh.a. dhe ‘Union Bank’ sh.a.”, është evidentuar se i licencuari ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga neni 7 i “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, që në fazën e parë të paraqitjes së kërkesës për autorizim për transferim asetesh.

- Për sa më sipër, me qëllimin për të orientuar më drejt vendimarrjen e Bordit të ERE-s, në referencë të lehtësimit të procedurave dhe në ndihmë të subjekteve aplikuese, duke mbajtur në konsideratë faktin që subjekti “SPV Blue 2” sh.p.k. është i licencuari i parë që ka plotësuar gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas nenit 7 të rregullores së sipërpërmendur dhe se nuk nevojitet të analizohet më tej asnjë dokument apo të përfshihet asnjë palë e tretë në procesin e transferimit të aseteve, Bordi do të vijojë me shqyrtimin në tërësi në rastin e këtij aplikimi dhe të çdo aplikimi që do të konstatohet me dokumentacion të plotësuar që në fazën fillestare.

- Ky vendim do të zbatohet për të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror që aplikojnë në ERE për marrjen e autorizimit për transferim asetesh dhe plotësojnë në mënyrë të saktë gjithë dokumentacionin e kërkuar, konform nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, që në fazën e aplikimit.

- Në këtë mënyrë, vendimi është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, sipas nenit 12 të Kodit të Procedurave Administrative, pasi është i nevojshëm për realizimin e qëllimit ligjor të rregullimit dhe unifikimit të praktikës së autorizimit

të transferimit të aseteve, është i përshtatshëm duke siguruar trajtim të barabartë dhe të njëtrajtshëm për të gjitha subjektet e licencuara që paraqesin dokumentacion të plotë dhe është në përputhje me drejtë me objektivin e ndjekur, duke shmangur procedura shtesë dhe kufizime të panevojshme ndaj subjekteve dhe duke garantuar një proces më të qartë, më të lehtë dhe më efikas.

- Neni 113 i ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikon mundësinë e ndryshimit të një akti me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar edhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Për të licencuarit që aplikojnë për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse, dhe që kanë plotësuar gjithë dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja e procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, që në fazën e parë të aplikimit, Bordi i ERE-s do të shprehet mbi kërkesën për dhënie autorizimi për transferim asetesh brenda 45 ditëve nga aplikimi.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë të gjitha palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

3. Ky vendim do të zbatohet për të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror që aplikojnë në ERE për marrjen e autorizimit për transferim asetesh dhe plotësojnë në mënyrë të saktë gjithë dokumentacionin e kërkuar konform nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, që në fazën e aplikimit, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të



bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTAR I BORDIT TË ERE-s
Petra Lika

VENDIM
Nr. 194, datë 12.8.2025

**MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA
ERE PËR TRANSFERIMIN NËPËRMJET
VENDOSJES SË BARRËS SIGURUESE
TË ASETEVE FIKSE TË SHOQËRISË
“SPV BLUE 2” SHPK**

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, germat “a” dhe “b”, 6, 7 dhe 8 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 12.8.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2199/1 prot., datë 7.8.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SPV Blue 2’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet marrëveshjes siguruese) të aseteve fikse të saj.”,

Konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënie e autorizimit për shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria me shkresën nr. 2199 prot., datë 29.7.2025, ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) me qëllim garantimin e shlyerjes së marrëveshjes së kredisë sindikale në favor të “Banka e Tiranës” sh.a., “Banka OTP Albania” sh.a., “Intesa Sanpaolo Bank

Albania” sh.a. dhe “Union Bank” sh.a., ku agjent i kredisë dhe i kolateralit është zgjedhur “Banka e Tiranës” sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur

- Shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 296, datë 30.12.2024, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaiik “Blue 2”.

- Nga shqyrtimi i aplikimit të përcjellë nga shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k., rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin/ informacionin e kërkuar në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 4, 6, 7 dhe 8, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, si vijon:

3. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 7:

- **Pika 1** – janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi kërkesën për transferim, ndër të tjera si më poshtë vijon:

- **germa “a”** – është depozituar ekstrakti historik i shoqërisë, i vlefshëm brenda afatit ligjor;

- **germa “b”** – është plotësuar informacioni mbi veprimtarinë e licencuar;

- **germa “c”** – është plotësuar informacioni mbi gjendjen financiare të kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efekti i pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve;

- **germa “d”** – është bërë një përshkrim i kandidatit;

- **germa “e” “f” dhe “g”** – arsyet e kërkesës, efektet në aktivitetin e licencuar dhe furnizimin e klientëve;

- **germa “h”** – janë depozituar marrëveshjet përkatëse;

- “Kontratë kredie” nr. 4338 rep., nr. 1877 kol., datë 30.5.2025, nënshkruar nga palët;

- Marrëveshjen siguruese (*marrëveshje barrë siguruese mbi asetet*) me nr. 4343 rep., nr. 1882 kol., datë 30.5.2025 të nënshkruar nga palët.

- **germa “i”** – deklarata e kredidhënësit për garantimin e vazhdimësisë së aktivitetit;

- **germa “j”** – deklarata dhe vërtetimi për mungesë transferimesh të mëparshme mbi asetet fikse.

- **Pika 3** – është plotësuar informacioni i kërkuar në këtë pikë që lidhet me detyrimet me të cilat ngarkohet subjekti për shkak të marrëveshjes së koncesionit në pjesët që transferojnë te përfituesi



përfshirë edhe informimin e Autoritetit Shtetëror, në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve.

- **Pika 4** – kërkesa për aplikim është nënshkruar nga administratori i shoqërisë, ndërsa dokumentet e tjera shoqëruese të këtij aplikimi janë nënshkruar nga administratori dhe/ose personat e autorizuar sipas rastit.

- **Pika 6** – shoqëria ka bërë me dije se kërkon të mos jenë të hapura për publikim, për arsye konkurrence, Marrëveshja e Barrës Siguruese mbi asetet me nr. 4343 rep., nr. 1882 kol., datë 30.5.2025, nënshkruar midis shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. dhe huadhënësve, Marrëveshja e Kredisë Sindikale me nr. 4338 rep., nr. 1877 kol., datë 30.5.2025, lista e aseteve për të cilat kërkohet marrja e autorizimit nga ERE, si dhe të dhënat ekonomike dhe financiare të shoqërisë. *Megjithatë, vlerësohet se, për arsye ligjore dhe në përputhje me parimin e transparencës së vendimmarrjes publike, disa nga këto elemente, si identiteti i kredidhënësve dhe lista e aseteve objekt i barrës, janë thelbësore për përmbajtjen e aktit administrativ dhe nuk mund të përjashtohen nga publikimi. Për rrjedhojë, lista e aseteve, duke qenë pjesë përbërëse e vendimit të ERE-s, publikohet së bashku me vendimin përkatës, ndërsa për pjesën tjetër të dokumentacionit do të mbahet në konsideratë konfidencialiteti i tyre nga ana e ERE-s.*

4. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të shoqërisë (sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi), nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese, me qëllim garantimin e shlyerjes së marrëveshjes së kredisë sindikale në favor të “Banka e Tiranës” sh.a., “Banka OTP Albania” sh.a., “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a. dhe “Union Bank” sh.a., ku “Banka e Tiranës” sh.a. është agent i kredisë dhe i kolateralit, nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

- Për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi asetet e shoqërisë për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi asetet e saj ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k., si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Banka e Tiranës” sh.a., “Banka OTP Albania” sh.a., “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a. dhe “Union Bank” sh.a., ku agent i kredisë dhe i kolateralit është zgjedhur “Banka e Tiranës” sh.a., që rrjedhin nga kontrata e kredisë nr. 4338 rep., nr. 1877 kol., datë 30.5.2025. (Lista e aseteve bashkëlidhur.)

2. Dhënia e autorizimit sipas përcaktimeve të pikës 1 nuk e çliron shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k. të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi asetet fikse të saj që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar, ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm, si dhe në rast të çdo ndryshimi në këtë marrëveshje, përfshirë transferimin të të tretët.

4. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se shoqëria dokumenton heqjen e hipotekës dhe barrës siguruese të radhës së parë të vendosur mbi asetet e saj.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë “SPV Blue 2” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTAR I BORDIT TË ERE-s
Petraq Lika**

LISTA E ASETEVE TË SHOQËRISË “SPV
BLUE 2” SHPK

1. Panele (solar module TSM-705-720 NEG21C.20), *me vlerë 5,331,563.42 euro.*
2. Pilote (mikro pilote), *me vlerë 772,400.07 euro.*
3. Struktura gjurmuese (Tracker Vanguard 1P), *me vlerë 3,856,101.93 euro.*
4. Inverter (SG350DHX-20 Multi-MPPT String Inverter for 1500 Vdc System), *me vlerë 1,096,842.18 euro.*
5. Transformatorë të tesionit të mesën (35KV GIS CCV Cabinet + 8960kVA 35/0.8-0.8kV Dyn11y11 Aluminium Winding Transformer + LV Panel + Aux. Transformer 5kVA 0.8/0.4kV + Container customization + A/C + 35kV Cable + LV Cable + Spare Parts for Box Type Subs), *me vlerë 861,588.00 euro.*
6. Kabllo (IEC60840 1x400mm² AL/XLPE/CTS/PVC 21/35kV (40.5), kabllo komunikimi, elektrik), *me vlerë 725,176.44 euro.*
7. Kabllo (kabllo optikë, tokëzimi dhe diellorë), *me vlerë 997,555.70 euro;*
8. Transformatori (220/35kV, 100/120MVA ONAN/ONAF Power Transformer including RTCC panel with German Brand A YR supporting protocol IEC61850 for connecting scada system), *me vlerë 850,000.00 euro.*

Vlera totale rezulton 14,491,227.74 euro.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë

